Prof.dr. Exhlale DOBRUNA-SALIHU

VESNA GIRARDI-JURKIQ (1944-2012)

Prof. dr. Vesna Girardi Jurkiq, arkeologe dhe ilirologe e njohur kroate, lindi më 1944 në Zagreb. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pulë, ndërsa arkeologjinë dhe gjuhën angleze në Universitetin e Zagrebit, pranë Fakultetit Filozofik, ku u diplomua më 1968. Po ky vit shënon edhe fillet e punës së frytshme arkeologjike me punësimin në Muzeun Arkeologjik të Istrës në Pulë. Me ecurinë e thirrjeve profesionale-shkencore, duke filluar nga kustosja e arkeologjisë antike dhe këshilltarja muzeore – ku udhëhiqte departamentin e arkeologjisë antike – deri te drejtoresha e muzeut, veprimtaria e saj në këtë muze është shumë dimenzionale.

Në bazë të shumë punimeve shkencore dhe profesionale nga Këshilli shkencor i Fakultetit Filozofik të Zagrebit në vitin 1979 mori titullin e magjistrit, kurse në vitin 2000 po në këtë fakultet doktoroi në temën "Kultovi u procesu romanizacije antičke Istre" (Kultet në procesin e romanizimit të Istrës antike), të cilën do ta publikojë pesë vite më vonë. Në vitin 2003 emërohet docente dhe nga ky vit ligjëronte në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Rijekës. Ndërkohë ka kryer një varg specializimesh në vende të ndryshme të Evropës.

Që nga punësimi në Muzeun Arkeologjik intensivisht është marrë me punë hulumtuese-shkencore në trevën e Istrës, duke iu përkushtuar sidomos studimit të kulteve dhe qendrave antike të kultit, si edhe të objekteve arkitekturore. Gjatë kësaj kohe, njëherësh, si autore dhe koautore, ka marrë pjesë në ngritjen e ekspozitave të përhershme dhe tematike kushtuar materialit arkeologjik të Istrës, ku këto të fundit janë prezantuar në vende të ndryshme të Evropës dhe Amerikës, në mesin e të cilave edhe një në Prishtinë me temën "Histrët dhe Etruskët".

Pos punës shkencore-muzeore, është dalluar edhe me veprimtari tjera. Mbi të gjitha ishte themeluese dhe udhëheqëse e Qendrës Ndërkombëtare hulumtuese për arkeologji Brijoni-Medulin të Universitetit të Zagrebit (1994), duke organizuar simpoziume arkeologjike tematike vjetore në Pulë nën patronatin e UNESCO-s në bashkëpunim me Universitetet e Kroacisë dhe të vendeve tjera të Evropës.

Kjo studiuese rezultatet e veprimtarisë së bujshme hulumtuese dhe shkencore i ka prezantuar në një mori simpoziumesh në vend dhe jashtë, duke botuar mbi 400 punime në më shumë se 40 publikime të ndryshme.

Po ashtu është autore dhe koautore e monografive të Pulës (Pola), Poreçit (Parentium) dhe qendrave tjera të Istrës.

Veprimtaria e saj hulumtuese-shkencore sidomos në fushë të ilirologjisë së trevës së Histrisë antike është e madhe, duke kontribuar në kulturën materiale dhe shpirtërore të popullsisë së kësaj treve (histrëve) në fushë të antikitetit.

Në kuadër të kulturës materiale është marrë me artin plastik të bust-portreteve, ku përmes trajtimit të tyre në stelat mbivarrore, vë në spikamë karakteristikat fizionomike të të ndjerëve në ekzemplarët e brendisë së kësaj treve – elementet fizike autoktone dhe variantet lokale të modës në krehjen e flokëve te gratë – të theksuara shumë qartë nga ana e mjeshtërve vendorë, ose edhe të huaj, të cilat, duke qenë në pajtim me antroponiminë e prejardhjes ilire, flasin qartë për praninë shumë të fortë të elementeve tradicionale autoktone.

Posaçërisht vëmendje i kushton studimit të kulturës shpirtërore në fushë të kulteve me një numër të madh publikimesh. Sidomos merret me kontinuitetin e kulteve ilire që nderoheshin gjatë kohës romake – kryesisht të perëndeshave – përmes një pasqyre të perëndive të paraqitura në dy forma. 1. Autoktone të emrit: perëndesha e territorit Histria, ose Terra Histria, apo Istria – ngjashëm me Perëndeshën dardane Dea Dardanica – Boria, Sentona, Iutossica, Iria, Ica dhe 2. Të sinkretizuar iliro-romake (intrpretatio Romana): A. Me kultin perandorak (apelativin Augusta), si Eia, Trita, Nebres, Aitica, Ika, Meloscus, dhe B. Të njësuar me një perëndi romake, si Iria Venus duke na e zbuluar emrin e perëndeshës vendëse ilire të bukurisë e dashurisë dhe Minerva Flanatica e Minerva Polensis, ku kemi të bëjmë me perëndeshën autoktone të identifikuar me perëndeshën romake të luftës. si dhe Ianus Pater, i cili barazohet me perëndinë latine Ianus.

Autorja, me një trajtim thelbësor të këtyre perëndive vë në spikamë edhe veçoritë e tyre. Që të gjitha, qoftë në formën autoktone, qoftë atë të sinkretizuar janë dëshmuar vetëm epigrafikisht, pos perëndeshës Eia, për të cilën supozohet se në skulpturë mund të jetë e paraqitur në medaljonin e frontonit të tempullit të vogël nga shekulli I në qendrën antike Nesactium (Visaqe), por ende e pa dokumentuar. Kurse numri i madh i kulteve të perëndeshave dëshmon qartë për praninë e matrijarhatit në kohën ilire, i cili tradiciona¬lisht vazhdon edhe në kohën romake. Shikuar nga ky aspekt, sidomos ka qenë i shprehur nderimi i kultit të pjellorisë, i cili figurativisht është i paraqitur në njërën anë të grupit skulpturor monolit nga koha e hekurit në Nezakc – unik jo vetëm në Istër, por në të gjithë territorin e ilirëve të Ballkanit. Kjo është skulptura e gruas që lind, e vetmja paraqitje antropomorfe e perëndeshës autoktone me emër të panjohur, e cila meqë në kuptimin simbolik personifikon kultin e pjellorisë në përgjithësi, autorja

supozon se paraqet Nënën e Madhe (Magna Mater), kulti i së cilës ka gjetur trevë të përshtatshme në besimet e lashta autoktone. Meqenëse në anën tjetër të grupit skulpturor është skalitur figura e një kalorësi me gjenitale të theksuara – i cili aq më shumë sipas autores paraqet perëndinë autoktone Meloscus, që del nga mbishkrimet e kohës romake – atëherë thekson se pa dyshim ky kompozicion skulpturor mund të lidhet me motivin e lindjes.

Çka është më më rëndësi, këto dedikime – të cilat ngriheshin edhe nga të ardhurit e rangjeve të ndryshme, duke i pranuar dhe nderuar kultet e këtyre perëndive – dëshmojnë se popullsia autoktone ilire e gadishullit të Histrisë gjatë shtatë shekujve të pushtetit romak në kulturën e tyre shpirtërore i ka ruajtur dhe respektuar traditat religjioze.

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje autorja njëherësh trajton edhe atë që ka të bëjë me fenomenin e kulteve prehistorike autoktone në raport me ato helenistike dhe greko roma¬ke, që në Histri mund të përcillet gjatë tërë antikitetit, e i cili më së miri pasqyrohet me skulpturat e gruas që lind, kalorësit "itifalik", si dhe të kokës së dyfishtë të perëndisë autoktone Jan.

Studimi i saj në fushë të kulteve, ku gjerësisht i trajtoi këto çështje, u kurorëzua me veprën Duhovna kultura antičke Istre (Kultura shpirtërore e Istrës antike), 1. "Kultovi u procesu romanizacije antičke Istre" (Kultet në procesin e romanizimit të Istrës antike), Zagreb 2005 e përbërë prej dy pjesëve: I. Analiza edhe II. Katalogu me material të pasur ilustrues, duke filluar nga kultet e perëndive autoktone, e me radhë romake dhe greko-orientale-romake, për të përfunduar me figura mitologjike. Si pjesë integrale e veprës janë: Përmbledhja në tri gjuhë (anglisht, italisht dhe gjermanisht) për opinionin e gjerë, të dhënat për autoren, shkurtesat, literatura, indekset e emrave dhe përmbajtja e detajuar. Autorja kishte planifikuar ta publikonte edhe librin e dytë, në të cilin punonte pa ndërpre.

Me këtë veprimtari të madhe arkeologjike dhe kontribut të pashembullt në fushë të kulteve ilire, Prof. dr. Vesna Giradi Jurkiq gjithmonë do të mbetet një arkeologe e madhe.